



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
K R Y E T A R I

Adresa: Rruga "AbdiToptani", nr.1, Tiranë; E-mail: klsh.org.al; Web-site: www.klsh.org.al

Nr. 371/6 Prot.

Tiranë, më 30.09.2019

V E N D I M
Nr. 98, Datë 30.09.2019

PËR
AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHOQËRINË "ALBPETROL" SHA PATOS "MBI
ZBATIMIN E PËRPUTHSHMËRISË"
për periudhën nga data 01.08.2018 deri më datën 30.06.2019.

Nga auditimi i ushtruar në "Albpetrol"SHA Patos rezultoi që, ka devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të cilat janë të përhapura dhe në disa raste edhe materiale.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i sigurimit të standardeve dhe Cilësisësi dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të nenit 10, 15, 25 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Mbi zbatimin e përputhshmërisë" të ushtruar në shoqërinë "Albpetrol" SHA Patos, sipas programit të auditimit nr. 371/1 Prot., datë 03.06.2019, për veprimtarinë nga data 01.08.2018 deri me datë 30.06.2019.

II. Të miratoj opinionin e auditimit, rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

A. OPINIONI I AUDITIMIT

Opinionin i kualifikuar i grupit të auditimit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së “Albpetrol” SHA Patos me kuadrin ligjor dhe rregullator.

Në opinionin tonë, përveç çështjeve të trajtuara në bazën për opinionin e modifikuar, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të cilat në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë të përhapura në ndonjë rast edhemateriale, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinionin të kualifikuar¹.

Baza për opinionin.

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik *ISSAI 4100*² – *Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me çështje të veçanta dhe ISSAI 4200 - Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi behet lidhur me auditimin e pasqyrave financiare.*

Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Theksim të çështjes

Ne duam të tërheqim vëmendjen e përdoruesve për disa çështje të cilat ndikojnë në cilësinë e informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, aktivitetit ekonomik dhe monitorimit të marrëveshjeve hidrokarbure, duke përfshirë dobësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe mospërputhje të veprimtarisë me aktet ligjore. Konkretisht:

- Dëme ekonomike-të ardhura të munguara nga zbatimi i marrëveshjeve hidrokarbure më vlerë 54.6 milionë Euro.

-Dëmet ekonomike të konstatuara janë në vlerën 0.7 milionë Euro, të cilat kanë ardhur si pasojë e keq menaxhimit në pagesat për udhëtime, djeta, shpërblime, procedurat e prokurimit, zbatimin e kontratave etj.

-Efekte negative financiare në vlerën 3.5 milionë Euro, të cilat kanë ardhur si pasojë e largimeve nga puna të punonjësve pa respektuar dispozitat ligjore, shërbime të realizuara nga Albpetrol SHA për kontraktorë në marrëveshje hidrokarbure, nga procedurat e prokurimit etj.

-Sistemet e kontrollit të brendshëm të implementuara nga institucioni nuk kanë rezultuar në përputhje me kërkesat e kriterëve të përcaktuara për vlerësimin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, për shkak të mungesës së kuptimit të këtyre kriterëve, mosplotësimit të kërkesave për dorëzimin e deklaratave për cilësinë e kontrolleve të brendshme, mosplotësimit dhe mosdorëzimit pyetësorëve të vetëvlerësimit, regjistrin të risqeve, rregullores pa mbështetje në strukturën organizative, veprimeve rregulluese të kryera nga jashtë, mbajtjes së regjistrimit

¹ MANUALI I AUDITIMIT PERPUTHSMERISE: Audituesi shpreh një konkluzion me rezerve kur në gjykimin profesional të tij, efekti ose efektet e mundshme të një çështjeje, nuk janë aq materiale sa që të justifikojnë një konkluzion të kundërt ose një refuzim të konkluzionit.

² “Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me çështje të veçanta”.

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: - Për periudhën janar-Dhjetor 2018 dhe Janar-mars 2019 (treguesit e 3 mujorit të dytë, kanë afat të paraqiten brenda 45 ditësh nga data e përfundimit), treguesit e realizuar, krahasuar me ato të programuar në marrëveshje hidrokarbure për zonën Patos-Marinëz paraqiten me devijime. Kontraktori ka një prodhim më të vogël se ai i miratuar në planin vjetor, por rezulton me rritje të të ardhurave në krahasim me planin vjetor. Për periudhën respektive, rezulton se prodhimi është më i lartë se programi i zhvillimit në sasinë 395478 ton, ose në masën 16.7 %, ndërsa shpenzimet janë rritur me vlerë 15,486 USD, ose në masën 13.8 %. Nëse marrin në konsideratë planet vjetore, prodhimi është rritur në sasinë 190330 ton, ose 3.1 %, ndërsa shpenzimet janë rritur me vlerë 155,024 USD ose në masën 38.3 %. Arrihet në konkluzionin se shpenzimet nuk i përgjigjen rritjes së prodhimit, duke rezultuar me një disproporcion të vazhdueshëm, krahasuar me planin e zhvillimit dhe planet vjetore, të cilat kanë ndikim negativ në arritjen e koeficientit R mbi 1 dhe arritjen e fitimit.

Nëse marrim në konsideratë prodhimin e vitit 2018, është më i lartë se ai i parashikuar në planin e zhvillimit por më i ulët se plani vjetor, ndërkohë që shpenzimet janë shumë më të larta se në planin e zhvillimit, apo raportin vjetor të miratuar (*Trajtuar më hollësisht në Pikë 10, faqe 100-118, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1 Rekomandimi: - Drejtoria e Marrëveshjeve Hidrokarbure pranë Albpetrol SHA, duhet të monitorojë e aktivitetin hidrokarbur të Kontraktorit në të gjitha aspektet, si duke i kërkuar respektimin e planit të miratuar për prodhimin e naftës brut, duke bërë inspektime të prodhimit faktik të puseve të naftës, inspektimin e makineri pajisje që furnizohen, sasinë e holluesit, ujin e përdorur etj., me synim rritjen e eficiencës së operacioneve hidrokarbure dhe rritjen e fitimit të Albpetrol por dhe Qeverisë nga kjo marrëveshje.

1.2.Rekomandimi: - Administratori dhe Drejtoria e Marrëveshjeve Hidrokarbure të marrin masa për pjesëmarrje dhe monitorim me korrektesë të procedurave të prokurimit që zhvillon kontraktori me vlerë më të madhe se 2 milionë USD, në zbatim të marrëveshjes hidrokarbure, në mënyrë që të marrin informacionin e duhur dhe reflektimin e rasteve të shkeljeve në raportet e operacioneve hidrokarbure që paraqet kontraktori.

Vazhdimisht

2. Gjetje nga auditimi: - Drejtoriae Marrëveshjeve Hidrokarbure pranë Albpetrol, për marrëveshjen hidrokarbure për zonën Patos-Marinëz, ka ngritur një grup pune të përbërë nga z. F.E dhe z. O.G për monitorimin e operacioneve hidrokarbure pranë stacionit Fier-Hub. Marrja e kampioneve është marrë në datat 09-14, datë 16, datë 18, datë 20 dhe datë 27.08.2018. Bazuar në relacionin nr. 10297 prot., datë 23.10.2018, janë marrë mostra të cilat janë analizuar në laboratorët e Albpetrol SHA, me qëllim përcaktimin e densitetit dhe sasisë së ujit në përmbajtje. Rezultatet e analizave janë krahasuar me të dhënat e Kontraktorit dhe ka rezultuar një diferencë në sasinë 87.9 ton, për periudhën e matjes 6 ditore (*Trajtuar më hollësisht në Pikë 10, faqe 100-118, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1 -Rekomandimi: - Drejtoria e Marrëveshjeve Hidrokarbure pranë Albpetrol SHA, duhet të ushtrojë inspektime të vazhdueshme në operacionet hidrokarbure edhe për zona të tjera në marrëveshje, me synim shmangien e abuzimeve në sasinë e naftës brut të prodhuar, krahasuar me atë të raportuar.

Vazhdimisht

3.-Gjetjengaauditimi: -Marrëveshjet hidrokarbure për “A.O&G” SHA dhe “T.S” SHA në periudhën e auditimit, kanë krijuar deficite në përmbushjen e detyrimeve për PPE dhe PPA në periudhat e fundit gjithsej në vlerën prej 2,580,737 USD të ardhura të munguara, përkatësisht për “A.O&G” SHA 2,435,218 USD dhe “T.S” SHA në vlerën 145,519 USD, duke shkaktuar probleme serioze në ecurinë ekonomiko-financiare të shoqërisë (*Trajtuar më hollësisht në Pikë 10, faqe 100-118, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1 Rekomandimi: Administratori i Albpetrol SHA, Drejtoria e Marrëveshjeve Hidrokarbure, krahas evidentimit të deficiteve në përmbushjen e detyrimeve për PPE dhe PPA në vite dhe në periudhat e fundit në mbledhjet e Komitetit Këshillimor, të njoftojnë me një relacion të hollësishëm Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë, për ecurinë e zbatimit të këtyre marrëveshjeve, të cilat po shkaktojnë probleme serioze në ecurinë ekonomiko-financiare të Albpetrol SHA dhe ekonomisë kombëtare në tërësi.

Brenda datës 30.11.2019

4.-Gjetjengaauditimi: Kontraktori “A.O&G” SHA nuk respekton afatin në dorëzimin e raporteve mujore dhe progres-raporteve tremujore, sipas përcaktimeve në Marrëveshjen Hidrokarbure; Ka devijime të theksuara të Programit dhe buxhetit vjetor nga ato të Planit të Zhvillimit, si dhe realizimi i tyre është i nivelit të ulët, duke ndikuar që faktori $R < 1$ jashtë çdo lloj parashikimi dhe me pasoja për përfitimin publik nga shfrytëzimi i pasurive natyrore të vendit. Gjithashtu vërehet se nuk ka një lidhje të fortë shpenzime-prodhim hidrokarbure duke bërë që marrëveshjet hidrokarbure të vazhdojnë të jenë vulnerabil (*Trajtuar më hollësisht në Pikë 10, faqe 100-118, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1 Rekomandimi: Administratori i Albpetrol SHA, Drejtoria e Marrëveshjeve Hidrokarbure, të mbajnë qëndrime rigorozë kundrejt miratimit të Programit dhe buxhetit vjetor në përputhje të Planit të Zhvillimit, si dhe realizimit të tyre, sëbashku me respektimin e afatit të dorëzimit të raporteve mujore dhe progres-raporteve tremujore nga ana e kontraktorëve të Marrëveshjeve Hidrokarbure, në funksion të përdorimit me efektivitet të burimeve natyrore të vendit.

Vazhdimisht

5.-Gjetjengaauditimi: Nga auditimet e Albpetrol SHA për zbatimin e marrëveshjes për vendburimin Ballsh-Hekal me kontraktorin "A.O&G" SHA, ka rezultuar se nuk do të njihen shpenzimet e kësaj periudhe në vlerën totale prej 416,560 USD si shpenzime të rimbursueshme, të cilat do të ndikojnë në rilloaritjen e faktorit R, gjë që tregon se shpenzimet e kontraktorëve nuk janë në përputhje me marrëveshjet hidrokarbure. (*Trajtuar më hollësisht në Pikë 10, faqe 100-118, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1 Rekomandimi: Administratori i Albpetrol SHA, Drejtoria e Marrëveshjeve Hidrokarbure, të marrin masat e nevojshme për të hartuar dhe dërguar në afat të gjithë dokumentacionin për auditimin e marrëveshjeve hidrokarbure, kryesisht për shpenzimet e parimbursueshme të cilat mund të jenë objekt arbitrazhi në të ardhmen.

Vazhdimisht

6.-Gjetjengaauditimi:- Në zonën e Marrëveshjes hidrokarbure për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve për vendburimin Gorisht – Kocul, e cila është rimarrë në administrim nga Albpetrol SHA në vitin 2017, nga inventarizimi i marrjes në përdorim rezulton se mungojnë

asete në vlerën prej 65,634,660 lekë (*Trajtuar më hollësisht në Pikë 10, faqe 100-118, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1 Rekomandimi: Administratori i Albpetrol SHA, Drejtoria e Marrëveshjeve Hidrokarbure, të marrin masat e nevojshme lidhur me zbatimin e kërkesave për inventarët e kontraktorëve të Marrëveshjeve hidrokarbure për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve, me qëllim që të shmangen situatat si ajo për vendburimin Gorisht – Kocul, e cila është rimarrë në administrim nga Albpetrol SHA në vitin 2017, nga inventarizimi i së cilës rezulton se mungojnë asete në vlerën prej 65,634,660 lekë, duke analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë për këtë të fundit.

Brenda datës 31.11.2019 dhe vazhdimisht

7. Gjetje nga auditimi Nga analizimi i treguesve në raportin analitik në lidhje me realizimin e të ardhurave dhe kostove hidrokarbure, në vendburimin Finiq-Krane, rezulton se nuk ka krijuar të ardhura, si pasojë e mos kryerjes së operacioneve hidrokarbure, në kundërshtim me gurmën (a) të pikës 12.1 dhe pikës 12.3 nën 12 të Marrëveshjes Hidrokarbure. Kontraktori thekson se arsyeja kryesore e mosrealizimit të planit të prodhimit dhe treguesve të tjerë është kryesisht ndërprerja e energjisë elektrike si pasojë e një rrjeti të amortizuar, dhe se përdorimi me burim alternativ, gjenerator elektrik, rrit koston e prodhimit. Por, nga relacionet i grupit të monitorimit në Drejtorinë e MH në AlbpetrolSHA. Nr.11340 Prot. Datë 14.11.2018, Nr.1393 Prot. Datë 13.02.2019, Nr. 1875 Prot. Datë 27.02.2019, theksohet mungesa e investimeve për kapacitete të lira grumbulluese me depozita, gjithashtu, mungesa e realizimit të investimeve për aktivizimin në prodhim të puseve të gatshëm për prodhim, mungesa e depozitës fiskale e gatshme për shitje dhe mungesa e lejes për pikën e lëvritimit për shitje të naftës në Finiq etj. Gjithashtu, bazuar në relacionin e monitorimit të AlbpetrolSHA. Nr.11340 Prot., datë 14.11.2018 në konkluzionet e grupit të monitorimit konstatohet se vendburimi Finiq- Krane rezulton i ndalur prej afro 6 Muaj për shkak të mospagesave të faturave të energjisë elektrike shoqërisë OSHE SHA dega Sarandë. Gjatë auditimit rezulton se në kundërshtim me nenin 25 të marrëveshjes hidrokarbure AlbpetrolSHA nuk ka kryer auditim të Kontraktorit për vendburimin Finiq-Krane, me gjithë situatën e papranueshme për mungesën e prodhimit dhe të investimeve të nevojshme, për të cilat Kontraktori ka raportuar. Krahas problematikës së mësipërme, duket sikur kontraktori përpiqet të rrisë shpenzimet operative krahasuar me ato kapitale, të cilat shoqërohen me ulje të prodhimit pa ulur shpenzimet në tërësi, duke ndikuar negativisht Faktorin R” (*Trajtuar më hollësisht në Pikë 10, faqe 110-118 të Raportit përfundimtar të Auditimit*).

7.1 Rekomandimi:Për të rritur efektivitetin në zbatimin e MH si edhe rolin përgjegjës në zbatim të kushteve të parashikuara në MH, AlbpetrolSHA duhet të marrë menjëherë të gjitha masat për auditimin e Marrëveshjeve Hidrokarbure lidhur me ecurinë e operacioneve hidrokarbure dhe kontrollin e kostos hidrokarbure.

Në vazhdimësi

8. Gjetje nga auditimit: Mbikëqyrësi i punimeve për kontratat “Rehabilitim i sistemit të injektimit të ujërave në stacionet, puset, grupet e prodhimit, Gorisht-Kocul”, dhe “Zëvendësime të pjesshme të linjave magjistrale të transportit të fluidit nga sektorët e prodhimit në stacionin e dekantimit, Gorisht” nuk ka ndjekur punimet sipas përcaktimeve kontraktore.

- Megjithëse konstatohet që punimet nuk janë realizuar sipas grafikut kohor, nuk ka asnjë dokument nga mbikëqyrësi i punimeve i cili të vërtetojë shqyrtimin e ndonjë pretendimi të

mundshëm të kontraktorit për vonesa të shkaktuara nga përgjegjësia e autoritetit kontraktor, apo vonesa që vijnë si pasojë e mos angazhimit të kontraktorit sipas kontratës.

- Nuk ka dokumentacion të paraqitur nga mbikëqyrësi i punimeve mbi volumet e realizuara (librezë masash), megjithëse është kryer volumi më i madh i punimeve, prova apo testime të materialeve të përdorura në objekt. Nuk rezulton të jenë realizuar pagesa, megjithëse nga dokumentacioni konstatohet se janë përgatitur dy situacione të pjesshme.

- Nuk është mbajtur ditar, nga i cili mund të vërtetohet koha e konsumuar në objekt në realizimin e punimeve.

- Nuk disponohen procesverbale të punimeve që bëhen të padukshme (të maskuara).

- Nuk ka instruksione urdhra me shkrim.

- Nuk ka dokumentacion të mbikëqyrësit të punimeve për verifikim të defekteve, pezullime të mundshme të punimeve.

- Nuk është formësuar dosja teknike e objektit, ku pasqyrohen të gjitha aktet e mbajtura gjatë zbatimit të objektit, që nga akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit, urdhra të ndryshëm, kundërshtitë dhe kontradiktat e lindura gjatë punës, ndërprerje të punimeve nëse ka dhe shkaqet që kanë çuar në këto ndërprerje, relacione teknike, si dhe të gjitha rrethanat e nevojshme për të dhënë kuadrin e plotë të të gjitha fazave të zbatimit të punimeve.

Në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 19.10.1998 “Për Kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar Neni 7 (*Trajtuar më hollësisht në Pikë 8, faqe 80-99, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1-Rekomandimi:- “Albpetrol” SHA, të monitorojë dhe kërkojë nga mbikëqyrësit e punimeve ndjekjen e zbatimit të kontratave dhe plotësimin e dosjeve teknike të objekteve. Nga ana e mbikëqyrësve të punimeve të verifikohen punimet e zbatuara, të shqyrtohet dokumentacioni i paraqitur nga kontraktorët me synim realizimin e punimeve në përputhje të plotë me përcaktimet kontraktore.

Vazhdimisht

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i specifikimeve teknike për dy procedurat e prokurimit në fushën e teknologjisë së informacionit, saktësisht “*Program kompjuterik për menaxhimin e magazinave dhe pajisja e tyre me barcode*” dhe “*Zhvillim dhe mirëmbajtje të infrastrukturës mbështetëse të sistemeve IT*”, u konstatua se janë hartuar në kundërshtim me Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pasi janë përdorur terma dhe kritere të cilat kanë ulur numrin e mundshëm të operatorëve ekonomik pjesëmarrës (*Trajtuar më hollësisht në Pikë 8, faqe 84-100, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.1 -Rekomandimi: - Albpetrol SHA në vijimësi t’i kushtojë vëmendje maksimale hartimit të specifikimeve dhe kritereve të pjesëmarrjes në procedurat e prokurimit publik, me qëllim pjesëmarrjen masive të operatorëve ekonomik duke përfitur vlera sa më ekonomike për zbatimin e investimeve në fushën e teknologjisë së informacionit.

Vazhdimisht

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës “*Program kompjuterik për menaxhimin e magazinave dhe pajisja e tyre me barcode*”, u programi nuk disponon elementët “Two-factor Authentication”, “mundësi kontrolli për të detyruar krijimin e passwordeve komplekse” dhe “mundësi rikuperimi të llogarisë nëpërmjet instruksioneve të dërguara automatikisht nga sistemi me email”, në kundërshtim me pikat 4.1.4.a.i, 4.1.4.a.iv.4 dhe 4.1.4.a.iv.8 të specifikimeve teknike të kërkuara.

Për marrjen në dorëzim të sistemit në kundërshtim me Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, duke mos qenë në përputhje të plotë me kërkesat (*Trajtuar më hollësisht në Pikë 8, faqe 84-100, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.1 -Rekomandimi: - Albpetrol SHA t’i kërkojë bashkimit i OE “K.” SHPK dhe “S. A” SHPK plotësimin e mangësive të sistemit “Program kompjuterik për menaxhimin e magazinave dhe pajisja e tyre me barcode”, pasi aktualisht ky program është brenda periudhës së garancisë.

Brenda periudhës së garancisë

11. Gjetje nga auditimi: - Nga auditimi i zbatimit të kontratës “Zhvillim dhe mirëmbajtje të infrastrukturës mbështetëse të sistemeve IT, u konstatua faqja Web nuk disponon elementin “Modul aplikimesh online”, si dhe nuk ka funksional elementin “Modul kontakti online”, në kundërshtim me specifikimet teknike të kërkuara. Gjithashtu faqja Web-i rezultoi i pasigurt tek shfletuesi Mozilla. Gjithashtu sistemi “Menaxhimi i problemeve të pajisjeve informatike, teknologjike dhe të prodhimit me anë të një sistemi “Helpdesk””, nuk disponon elementet “Ndërfaqja e chatit të mos mbyllet kur hapet një dritare tjetër, pra duhet të jetë dritare me prioritet në mënyrë që të informojë userin në çdo çast”, “Të krijojë grupe chatesh”, si dhe nuk krijon raporte dhe nuk është i aksesueshëm në shfletuesin “Internet explorer”, në kundërshtim me pikat 4.1, 5.5, 5.3 dhe 9 të specifikimeve teknike (*Trajtuar më hollësisht në Pikë 8, faqe 84-100, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11.1 -Rekomandimi: -Albpetrol SHA t’i kërkojë bashkimit i OE “K.” shpk, “S. M. D.” shpk dhe “S. A.” SHPK plotësimin e mangësive të sistemit “Program kompjuterik për menaxhimin e magazinave dhe pajisja e tyre me barcode”, pasi aktualisht ky program është brenda periudhës së garancisë.

Brenda periudhës së garancisë

12. Gjetje nga auditimi: Referuar dokumentacionit të bankës konstatohet se në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011, pika 36, janë kryer pagesat e mëposhtme pa urdhër justifikues:

-Me transaksionin në BKT datë 11.01.2019, është paguar T. SHPK për faturën nr. 244, datë 24.12.2012, për shërbimin “Drekë pune”, në shumën 126,000 lekë, me faturën nr.87, datë 27.05.2019, për shërbimin “Drekë pune”, në shumën 120,000 lekë dhe me faturën nr.88, datë 05.06.2019, për shërbimin “Drekë pune”, në shumën 120,000 lekë.

-Me transaksionin në BKT datë 21.12.2018, është paguar T.-I. SHPK për faturën nr. 8859681, datë 21.12.2012, për shërbimin “Blerje ushqimore”, në shumën 382,000 lekë dhe me transaksionin në BKT datë 21.12.2018, është paguar F. T. SHPK për faturën nr. 1985, datë 20.12.2012, për shërbimin “Blerje ushqimore”, në shumën 279,414 lekë (*Trajtuar më hollësisht në Pikë 8, faqe 84-100, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

12.1 -Rekomandimi: -Nga Administratori shoqërisë Albpetrol SHA dhe Drejtoria e Financës, të merren masa për plotësimin me përgjegjësi të dokumentacionit shoqëruar të praktikave të bankës.

Vazhdimisht

13. Gjetje nga auditimi: Është paguar shoqëria “Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve Dega Rajonale Fier” në shumën 2,988,320 lekë bazuar në vendimin me nr.regj.323, datë 03.01.2018, të “Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë” (2,000,000 lekë gjobë

administrative, 720,000 lekë kamatëvonesa dhe 261,120 lekë shpenzime përbarimore. Në lidhje me këtë gjobë rezultoi se më datë 10.05.2017 gjatë inspektimit të ushtruar nga punonjësit e organit publik në ambientet e shfrytëzimit të naftës të subjektit tregtar “Albpetrol SHA” është konstatuar se, ky subjekt nuk kishte përmbushur detyrat e lëna nga inspektimi i mëparshëm në kohë dhe nuk ishte pajisur me leje mjedisore të tipit A (*Trajtuar më hollësisht në Pikë 7, 79-84, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

13.1-Rekomandimi: -Nga Administratori shoqërisë Albpetrol SHA dhe Drejtorja e Mjedisit, të merren masa për zbatimin me përgjegjësi të detyrave të lëna nga Inspektorati Shtetëror i mjedisit dhe Pyjeve, për të shmangur rastet e ndëshkimit të shoqërisë.

Vazhdimisht

14. Gjetje nga auditimi: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Albpetrol SHA, rezultoi se gjatë periudhës objekt auditimi i janë akorduar A., me vendimet përkatëse të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjetikës (MIE), tre hua në vlerën **178,964,672 lekë**.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit konstatohet se:

1.Këto hua janë dhënë në kundërshtim me VKM nr.848, datë 07.12.2016 “Për krijimin e shoqërisë A. SHA dhe përcaktimin e Autoritetit Publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive Albpetrol SHA dhe A.SHA”, pika 8.

e cila përcakton se:

2.Nuk janë vendosur në asnjë kontratë penalitete në rast të mos përmbushjes të detyrimeve të palëve, gjë që rrezikon mos përmbushjen e detyrimeve të palëve me efekt negativ për ecurinë e Albpetrol SHA.

3.Për periudhat e mëparshme i janë akorduar A. SHA katër hua me vlerë 218,931,430 lekë. Nga ana e A. nuk është kryer asnjë pagesë për shlyerjen e huave, megjithëse afati i shlyerjes të këtij detyrimi ka përfunduar (*Trajtuar më hollësisht në Pikë 7, faqe 79-84, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

14.1 Rekomandimi:Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë Albpetrol SHA, të hartohet një raport konkret për të gjitha rastet e dhënies së huave dhe situatën në lidhje me to, duke u përqendruar në efektin negativ në zhvillimin e shoqërisë Albpetrol SHA nga dhënia e huave duke njoftuar për këtë Asamblenë e Aksionarëve (Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës)

Vazhdimisht

15. Gjetje nga auditimi: Shoqëria Albpetrol SHA ka paraqitur “Aktivet Afatgjata Materiale” me vlerën 34,864,090 mijë lekë, krahasuar me vlerën prej 46,358,258 mijë lekë të paraqitur në vitin 2017. Këto Aktive janë paraqitur në vlerën e drejtë duke u mbështetur në rivlerësimin e kryer nga vlerësues të pavarur, sipas raportit të datë 20.02.2017, i cili vlerëson aktivet në datën 01.01.2015. Ri paraqitja e aktiveve me këtë vlerë të drejtë është kryer vetëm në pasqyrat financiare të periudhës 2018. Referuar standardit SNK 16 “Aktivet Afatgjata Materiale” ri paraqitja duhet të kryhej duke filluar nga periudha 2015 në mënyrë retrospektive. Për rrjedhojë në 31.12.2017 AAM janë të mbivlerësuara për 12,083,155 mijë lekë, rezervat e rivlerësimit janë të mbivlerësuara për 6,538,141 mijë lekë dhe fitimi i pashpërndarë është mbivlerësuar për 6,206,927 mijë lekë.

- Sa i takon llogarisë “Detyrime të tjera”, shoqëria Albpetrol SHA, ka paraqitur në 31.12.2018 vlerën prej 240,099 mijë lekë të barabartë me vlerën e vitit 2017. Këto balanca paraqiten si kundërvlerë e AAM, të cilat shoqëria nuk i disponon apo janë jashtë përdorimit. Në këto kushte duhej të ishte zbatuar SNK 16 duke i njohur këto vlera si pakësim i Aktiveve Afatgjata

Materiale, dhe jo si kundërvlerë e tyre. Pra rezulton se AAM dhe Detyrime të tjera janë mbivlerësuar në vlerën 240,099 mijë lekë. Kjo shumë mund të sjellë efekte negative në Pasqyrat Financiare të shoqërisë. *(Trajtuar më hollësisht në Pikë 5, faqe 41-64, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1 Rekomandimi: Nga drejtoria e Financës në bashkëpunim me specialistët e fushës, të kryen sistemimet e nevojshme, si dhe të kryhet një analizë e hollësishme për rivlerësimin e aktiveve.

Brenda vitit

16. Gjetje nga auditimi: Shoqëria Albpetrol SHA ka paraqitur në datë 31.12.2018 inventarin me vlerë 2,589,561 mijë lekë, krahasuar me vlerën prej 2,978,209 mijë lekë të paraqitur në vitin 2017. Referuar parashikimit në SNK 2 “Inventarët”, kur inventarët dëmtohen, janë bërë pjesërisht ose tërësisht të vjetërsuar, ose nëse çmimet e shitjes së tyre kanë rënë, shoqëria duhet të kryejë zhvlerësimin e inventarëve poshtë kostos deri në vlerën neto të realizueshme. Shoqëria trashëgon inventarë të vjetër në vlerën 1,447,815 mijë lekë dhe ka njohur zhvlerësime për inventarët në vlerën 137,487 mijë lekë për periudha të mëparshme. Nuk është kryer testi i vlerës së inventarit dhe llogaritja e zhvlerësimit në datën e Pasqyrave Financiare më datë 31.12.2018 *(Trajtuar më hollësisht në Pikë 5, faqe 41-64, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

16.1 Rekomandimi: Nga drejtoria e Financës dhe specialistët e fushës të kryhet testi i zhvlerësimit të inventarëve dhe llogaritja e zhvlerësimit në mënyrë që paraqitja në pasqyrat financiare të mundësojë paraqitjen e efekteve të mundshme nga zhvlerësimi. Shoqëria Albpetrol SHA të zbatojë dhe të interpretojë me korrektësi Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit, aq më tepër kur ky vlerësim është me efekte materiale në rezultatin e pasqyrave financiare

Brenda vitit 2019

17. Gjetje nga auditimi: Shoqëria Albpetrol SHA ka paraqitur “Llogari të arkëtueshme të tjera” në vlerën 3,493,244 mijë lekë, krahasuar me vlerën prej 2,497,786 mijë lekë te vitit 2017. Në këtë vlerë përfshihen:

-Të drejtat ndaj të tretëve për kontrata hidrokarbure, me vlerën neto 2,296,145 mijë lekë krahasuar me vlerën 2,497,786 mijë lekë. Këto vlera përfaqësojnë vlerën neto përkatëse të sasisë së produktit që është llogaritur sipas parashikimit të kontratave hidrokarbure, por që nuk është lëvruar fizikisht në depozitat e shoqërisë. Këto vlera nuk janë konfirmuar në tërësi si detyrim nga ana e kontraktorëve, janë të kontestuara në rrugë ligjore prej tyre. Shoqëria nuk ka krijuar provizione lidhur me këto fakte dhe ngjarje ekonomike.

-Të drejta ndaj të tretëve për huatë e dhëna me kontratë huaje sipas urdhrave të aksionarit janë paraqitur në vlerën 446,070 mijë lekë krahasuar me vlerën prej 316,071 mijë lekë të paraqitur në vitin 2017. Duke qenë se njësitë për të cilat janë dhënë huatë janë shoqëri që i kanë pushuar aktivitetet, nuk shihen mundësi për arkëtimin e tyre. Shoqëria nuk ka krijuar provizione lidhur me këto fakte dhe ngjarje ekonomike.

-Aktive të tjera mbi një vit paraqiten në vlerën prej 624,074 mijë lekë, krahasuar me vlerën prej 1,323,389 mijë lekë në vitin 2017. Për këtë pikë nuk ka informacione të mëtjeshme, dhe nuk krijohet siguria e arsyeshme dhe e besueshme.

- Shoqëria Albpetrol SHA ka paraqitur në “Llogari të arkëtueshme tregtare” vlerën prej 15,948,387 mijë lekë krahasuar me vlerën prej 16.232.706 mijë lekë në vitin 2017. Për këto shuma nuk arrihet siguri e arsyeshme dhe e mjaftueshme, as përmes letrave të konfirmimit dhe

as përmes kryerjes së procedurave alternative. Shoqëria nuk ka kryer teste zhvlerësimi dhe as nuk ka llogaritur zhvlerësimin për kërkesat e arkëtueshme, por ka paraqitur si zhvlerësim përgjithësisht llogaritë që janë me vjetërsi mbi pesë vite dhe që mundësinë e arkëtimit të këtyre llogarive janë konsideruar nga drejtimi si pa shpresë. Si pasojë efektet e mundshme të këtyre nuk mund të vlerësohen.

-Shoqëria Albpetrol SHA ka paraqitur në gjendja e llogarive tregtare në vlerën prej 8,863,618 mijë lekë krahasuar me vlerën prej 8,803,693 mijë lekë në vitin 2017. Për këto shuma nuk arrihet siguri e arsyeshme dhe e mjaftueshme, as përmes letrave të konfirmimit dhe as përmes kryerjes së procedurave alternative. Si pasojë efektet e mundshme të këtyre nuk mund të vlerësohen.

- Shoqëria Albpetrol SHA nuk ka paraqitur shënime për aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara në përputhje me SNK 37, dhe as shënimet për instrumentet financiare së bashku me shënimet e menaxhimit të riskut në përputhje me SNRF 7 (*Trajtuar më hollësisht në Pikë 5, faqe 41-64, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

17.1 -Rekomandimi:- Nga drejtoria e Financës të merren masa për kontabilizimin e llogarive të arkëtueshme dhe për krijimin e provizioneve lidhur me drejtat ndaj të tretëve, të kryhen procedurat e testeve të zhvlerësimin dhe provizionimit, të sistemohen dhe të plotësohen shënimet në përputhje me Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit.

Vazhdimisht

18. -Gjetjengaauditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Këshillit Mbikëqyrës, konstatohet se:

- Këshilli Mbikëqyrës nuk e ka kryer veprimtarinë e tij në përputhje të plotë me kuadrin rregullator përkatës në drejtim të raportimit të aktivitetit; planifikimit të veprimtarisë; dokumentimit të mbledhjeve me libër të veçantë protokollit; analizën e zbatimit të vendimeve të marra; ushtrimin e kompetencave në kontrollin e mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare të shoqërisë nga administratorët etj.

- Janë marrë vendime të pabazuara ligjërisht: vendimi nr.22, datë 24.12.2018; mungesa e firmosjes nga Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës të dy vendimeve të mbledhjes së datës 30.01.2019; vendimi qarkullues nr.6/1 datë 21.03.2019 dhe nr. 12, datë 25.04.2019 etj.; ose jashtë afateve të përcaktuara në udhëzime të veçanta si vendimi nr. 21, datë 19.10.2018 etj.

- Anëtarët e Këshillit mbikëqyrës kanë përfituar padrejtësisht furnizim me naftë në kundërshtim me Ligjin nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, neni 160; VKM nr. 642, datë 11.10.2005 “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore” i ndryshuar, pika 6 paragrafi i fundit; si dhe VKM nr.570, datë 03.10.2018 “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore” pika 6 në vlerën 477,440 lekë. (*Trajtuar më hollësisht në Pikë 2, faqe 24-28, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

18.1 Rekomandimi:Këshilli mbikëqyrës të marrë masa për planifikimin, dokumentimin dhe raportimin e veprimtarisë tij; analizën e zbatimit të vendimeve të marra; ushtrimin e kompetencave në kontrollin e mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare të shoqërisë; anulimin e vendim-marrjeve të pabazuara ligjërisht, si dhe të heq dorë nga përfitimet e paligjshme.

Vazhdimisht

19. -Gjetjengaauditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Administratorit, konstatohet se, relacionet që shoqërojnë praktikën e vendim-marrjes së Administratorit, ka raste që nuk janë të firmosura nga të gjithë punonjësit që kanë përgatitur materialet (*Trajtuar më hollësisht në Pikë 2, faqe 24-28, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

19.1 Rekomandimi: Administratori gjatë veprimtarisë së tij të administrojë dhe të vlerësojë të gjitha relacionet përkatëse jo vetëm nga ana e përmbajtjes por edhe formale (si data, referencat ligjore, nënshkrimet etj.) për të siguruar vendim-marrje të bazuar dhe argumentuar.

Vazhdimisht

20. -Gjetjengaauditimi: Vendimet e marra nga administratori në pjesën më të madhe janë për çështje të marrëdhënieve të punës, por që nisur nga penalizimi i shoqërisë në periudhat e mëparshme për largimet e paligjshme nga puna, si dhe çështjet në proces gjykimi, tregon se nuk është zbatuar drejtë kuadri ligjor përkatës. *(Trajtuar më hollësisht në Pikë 2, faqe 24-28, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

20.1 Rekomandimi: Për të gjitha vendim-marrjet që kanë të bëjnë me administrimin e marrëdhënieve të punës të kërkojë relacion të hollësishëm nga drejtoritë teknike, juridike dhe burimet njerëzore, me synim argumentimin e tyre ligjor dhe shmangien e problemeve financiare për Albpetrol SHA dhe atyre sociale për punonjësit.

Vazhdimisht

21. -Gjetjengaauditimi: Përgjithësisht, në praktikën e vendimeve mbi fitimin e munguar bujqësor si rezultat i marrjes në përdorim të tokës bujqësore që shërben në prodhimin e hidrokarbureve si shesh për shfrytëzimin e tyre ka mangësi në plotësimin e tyre, afatet kohore, mospërputhje të zërit të sipërfaqes së tokës në zotërim etj., duke shkaktuar dyshime të arsyeshme mbi saktësinë e përfitimeve të akorduara. *(Trajtuar më hollësisht në Pikë 2, faqe 24-28, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

21.1 Rekomandimi: Drejtoria Juridike në bashkëpunim me Mjedisin dhe atë financës të hartojë dhe të miratojë procedura të posaçme të përditësuara me legjislacionin aktual për praktikën e vendimeve mbi fitimin e munguar bujqësor si rezultat i marrjes në përdorim të tokës bujqësore nga Albpetrol SHA që shërben në prodhimin e hidrokarbureve, me qëllim që të shmangen praktikën e parregullta në këtë drejtim.

Brenda datës 30.10.2019

22. -Gjetjengaauditimi: Vendimet për dhënie karburanti për këshillin mbikëqyrës, për shtesë page dhe shpërblim për zbatim kontrate janë të paargumentuara dhe në kundërshtim me Ligjin nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, neni 160; VKM nr. 642, datë 11.10.2005 “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore” i ndryshuar, pika 6 paragrafi i fundit; si dhe VKM nr.570, datë 03.10.2018 “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore” *(Trajtuar më hollësisht në Pikë 2, faqe 24-28, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

22.1 Rekomandimi: Administratori të marrë masa për anulimin e Vendimeve: nr.139, datë 05.04.2019 “Për një ndryshim në Vendimin nr.317, date 04.11.2013 mbi miratimin e kuotës së karburantit të anëtarëve të Këshillit mbikëqyrës të shoqërisë Albpetrol SHA”; nr.281, datë 05.06.2019 Për miratimin e shtesës mujore mbi pagë në masën 10,000 lekë për njësinë e autoritetit përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave, si dhe nr.301, datë 12.06.2019 “Për shpërblimin e anëtarëve të grupit të punës“ në masën e ½ page mujore për punonjësit e QFT Patos që kanë kryer evadimin e mallrave dhe materialeve sipas kontratës nr.11860/11, datë 21.01.2019, për shkak se janë të bazuar ligjërisht.

Menjëherë

23.-Gjetjengaauditimi: Në procedurën e prokurimit tender i hapur “Blerje uniforma pune për punonjësit” të datës 28.01.2019 me vlerë 16,530,900 lekë, grupi i punës për përlllogaritjen e fondit limit me veprimet dhe mosveprimet e tij nuk ka harmonizuar alternativat dhe nuk ka zbatuar me përpikmëri nenin 59 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, duke shkaktuar rritjen e paargumentuar të kostos për këtë procedurë prokurimi prej 2,171,910 lekë (*Trajtuar më hollësisht në Pikë 2, faqe 24-28, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

23.1 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë, në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor të marrë masa për trajnimin e zyrtarëve të prokurimit dhe monitorimin e tyre, me qëllim ezaurimin e plotë dhe të saktë të alternativave të mundshme të përcaktimit të fondit limit, me qëllim maksimizimin e efektivitetit të përdorimit të fondeve publike.

Vazhdimisht

24.-Gjetjengaauditimi: Gjatë zbatimit të kontratës për procedurën e prokurimit Kërkesë për propozim me mjete elektronike “Blerje goma automjetesh” nënshkruar më datë 12.11.2018 me vlerë të përgjithshme prej 6,508,200 lekë pa TVSH,

- Komisioni teknik për kolaudimin dhe marrjen në dorëzim të gomave, ka marrë 9 artikuj me vlerë 1,067,000 lekë të prodhuara mbi 6 muaj nga data e furnizimit në kundërshtim me specifikimet teknike të kontratës;

- Administratori i Albpetrol SHA nuk ka respektuar kërkesat e Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011 i ndryshuar lidhur me përbërjen e Komisionit teknik për kolaudimin dhe marrjen në dorëzim të gomave, pasi juristi dhe kolaudatori nuk janë specialistë të fushës, si dhe nuk është përfshirë punonjësi me përgjegjësi materiale.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme kanë sjellë si pasojë marrjen e mallit me cilësi jo në përputhje me specifikimet e kontratës (*Trajtuar më hollësisht në Pikë 8, faqe 84-100, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

24.1 Rekomandimi: Administratori në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor të marrë masat e nevojshme për caktimin e zyrtarëve të prokurimit në përputhje me kërkesat e harmonizuara të kuadrit rregullator, si dhe të bëjë monitorimin e veprimtarisë së tyre.

Vazhdimisht

25.-Gjetjengaauditimi: - Në QSHANG Patos zbatohen 25 kontrata të ndryshme për shitjen e gazit, nga 5 faqe që ka secila, në faqen 2 mungon firma e përfaqësuesit ligjor e furnizuesit Albpetrol SHA dhe është vetëm me firmën e blerësit, gjë që të çon në dyshimin e arsyeshëm se kontratat kanë pasur ndërhyrje në zëvendësimin e kësaj flete;

- Sipas të dhënave nga QASHNG Patos nga 26 kontratat e shitjes së gazit të vitit 2018, 23 prej tyre nuk kanë paguar në Albpetrol SHA 20% të vlerës së kontratës në momentin e lidhjes, në zbatim të nenit 4 të kontratës, duke rrezikuar krahas të tjerave krijimin e detyrimeve debitorë dhe abuzimin me kontratën.

- Për subjektin G. B. ka dy kontrata furnizimi brenda së njëjtës periudhë: e datës 18.05.2018 me afat deri me 18.05.2019 për sasinë 400 N/m³ gaz në muaj, si dhe e datës 24.10.2018 po me afat një vjeçar (*Trajtuar më hollësisht në Pikë 8, faqe 84-100, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

25.1 Rekomandimi: Administratori i Albpetrol SHA të marrë masat e nevojshme për të analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë dhe kthimin në kushte ligjore të kontratave për shitjen e gazit, duke kërkuar pagesën prej 20 % të vlerës së kontratës, sipas përcaktimeve në këtë dokument ligjor.

Brenda datës 30.10.2019

26.-Gjetjengaauditimi: - Kontrata e furnizimit me gaz për subjektin “A. O.&G.” SHPK është kopje e datës 05.11.2018 me afat një vjeçar për sasinë mujore 25,000 N/m³, me 5 fletë nga të cilat 4 vetëm me firmën e përfaqësuesit ligjor të blerësit A. P., ndërsa fleta e fundit me firmat e përfaqësuesit ligjor të furnizuesit Albpetrol SHA z. K.Bdhe të blerësit “A.O&G.” SHPK.

- Kontrata e furnizimit me gaz për subjektin “A.O&G.” SHPK ka përcaktuar çmimi i shitjes prej 50 lekë për 1000 N/m³, pra 49,95 lekë për N/m³ më pak se sa përcaktimi i çmimit të shitjes në Programin ekonomik të Albpetrol SHA. Në këtë mënyrë shoqërisë Albpetroli është shkaktuar deri tani një dëm prej 10,881,607 lekë.(*Trajtuar më hollësisht në Pikë 8, faqe 84-100, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

26.1 Rekomandimi: Administratori i Albpetrol SHA të rinegociojë dhe të vërë në kushte ligjore kontratën e furnizimit me gaz për subjektin “A.O.&G.” SHPK, duke vendosur çmimi i shitjes prej 50 lekë për N/m³, sipas përcaktimit të këtij çmimi të shitjes në Programin ekonomik të Albpetrol SHA.

Brenda datës 30.10.2019

27.-Gjetjengaauditimi: - Në vitin 2019 janë aktive 19 kontrata të furnizimit me gaz, 16 nga të cilat vazhdojnë të furnizohen edhe pse kanë detyrime të papaguara për gazin e furnizuar, në një kohë që në zbatim të pikës 6.1 të nenit 6 të kontratës, furnizuesit i ka lindur e drejta të zgjidhë menjëherë kontratën, kur blerësi nuk paguan detyrimin brenda 30 ditëve.

- Nga zbatimi i kontratave të shitjes së gazit për vitin 2018 dhe janar-qershor 2019 është krijuar detyrimi i pa likuiduar prej 10,770,442 lekë, e cila përbën dëm ekonomik për Albpetrol SHA (*Trajtuar më hollësisht në Pikë 8, faqe 84-100, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

27.1 Rekomandimi: Administratori i Albpetrol SHA dhe Drejtori i QASHNG Patos të marrin masa për të velur detyrimet debitore prej 10,770,442 lekë, duke nisur nga zgjidhja e kontratës dhe deri në procedim gjyqësor.

Menjëherë

28. Gjetje nga auditimi: Prodhimi i naftës nga veprimtaria prodhuese e shoqërisë Albpetrol SHA përgjatë vitit 2018 u realizua 89477 ton nga 100419 ton të programuar ose 89.1% me një bazë mesatare ditore prej 245.14 Ton/ditë. Në treguesit e kompanisë është përfshirë edhe aktiviteti i M-H, nga i cili PPE+PPA i llogaritur për vitin 2018 është 43,657 ton kundrejt një programi prej 44,313 ton. Për vitin 2018, është bërë hyrje nga Kontraktorët, sasia 57,072 ton naftë, nga e cila 38,598 ton përbën detyrimin vjetor, ndërsa pjesa tjetër përbën detyrime të prapambetura kryesisht nga B.P.A Ltd.

Nga kalkulimet e të dhënave detyrimi (PPE+PPA) total i mbetur deri më 31 Dhjetor 2018 rezulton 60397.57 ton naftë. Prodhimi i gazit nga vet Albpetrol për vitin 2018 u realizua 629 mijë N/m³ nga 1020 mijë N/m³ programuar ose 61.66 %. Investimet për vitin 2018 janë realizuar në vlerën 465,854 mijë lekë nga 735,948 mijë lekë të programuar ose 63.3 %. Nga auditimi rezulton se për shkak të ristrukturimit dhe rishikimit të programit ekonomiko-financiar, një pjesë e investimeve nuk u realizuan. Gjithashtu, një pjesë e investimeve të realizuara në vitin 2018 i përkasin realizimit të kontratave të investimeve për vitin 2017.

AlbpetrolSHA për 3 mujorin I të vitit 2019 vazhdon edhe gjatë këtij viti të ketë një mosrealizim të planit ekonomiko-financiar. Nuk dokumentohet një monitorim i vazhdueshëm nga Administrata Qendrore përkundrejt Qendrave të Prodhimit të naftës në mënyrë që të punohet dhe nxiten qendrat për të çuar përpara proceset sipas programit (*Trajtuar më hollësisht*

në Pikë 4, faqe 36-41, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

28.1 -Rekomandimi:- Shoqëria Albpetrol SHA të analizojë shkaqet dhe faktorët që ndikojnë mosrealizimin e buxhetit, duke u mbështetur në faktorët realë të riskut.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

29. Gjetje nga auditimi: Shoqëria Albpetrol SHA nuk ka krijuar dhe transferuar fondin e veçantë monetar për ish-të përndjekurit politik, në zbatim të ligjit nr. 7598, datë 01.09.1992 “Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish-të dënuarit e të përndjekurit politikë”, shkronja “b” të nenit 1 dhe VKM nr. 392, datë 12.08.1999 “Për administrimin e fondit të veçantë monetar, të krijuar sipas ligjit nr. 7598, datë 01.09.1992 “Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish-të dënuarit e të përndjekurit politikë për të arkëtuar për llogari të Institutit të Integritimit të ish-të Përndjekurve Politikë shumën **1 %** të fondit të pagave për vitin 2018. Për periudhë e auditimit, shuma që duhej të paguajë kompania në total është rreth **10,843,575** lekë (*Trajtuar më hollësisht në Pikë 3, faqe 28-36, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

29.1 Rekomandimi: AlbpetrolSHA duhet të derdhë në favor të Institutit të Integritimit të ish të Përndjekurve Politikë shumën **1 %** të fondit të pagave për vitin 2018 dhe 2019. Detyrimi i Shoqërisë vetëm për 11 muajt e periudhës së audituar është **10,843,575** lekë.

30. Gjetje nga auditimi: Shoqëria Albpetrol sha ka realizuar inventarizimin e gjithë Shoqërisë në fund të vitit 2018 në zbatim të ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, mbështetur në nenin 158, pika 3 germa a, neni 166 pika 1, i ligjit 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtarë”, i ndryshuar, Statutin e Shoqërisë AlbpetrolSHA. Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011.Nga auditimi u konstatua se në inventarët qarkulluese ka mallra me qarkullim të ngadalte në vlerën **1,161,977 mijë lekë** dhe mallra stocq në vlerën **261,824 mijë lekë**. Edhe nga pasuritë e paluajtshmen AAM ka aktive jashtë funksionit në vlera të konsiderueshme (*Trajtuar më hollësisht në Pikë 6, faqe 64-79, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

30.1 Rekomandimi: Shoqëria nëpërmjet drejtimit të saj, duhet të marrë masa për: a- një vendimmarrje në lidhje me artikujt e magazinës të evidentuar dhe të listuar stok, me qarkullim të ngadalshëm dhe të papërdorshëm për veprimtarinë ekonomike në shkallë shoqërie, në përputhje me kriteret ligjore të trajtimit të tyre; b. asetet jashtë funksionit që nuk i shërbejnë aktivitetit kryesor të Shoqërisë, të shihet mundësia e dhënies në përdorim të tretëve dhe gjenerimit të të ardhurave.

Në vazhdimësi

31. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i regjistrimit të pronave të patundshme të Shoqërisë Albpetrol u konstatua se, në shkelje të pikës 7 kur flitet për detyrat e Drejtorisë Juridike dhe në pikat 6 e 13 kur flitet për detyrat e Drejtorisë së Privatizimit dhe Administrimit të Pronës në Rregulloren Nr.1357 datë 22.04.2013 të Shoqërisë, janë të pa regjistruara në ZVRPP-të vendore përkatëse **1776** puse dhe **21** objekte të Shoqërisë ose në total **1,797** pasuri të saj. Nga auditimi u konstatua se numri i pasurive të patundshme të shoqërisë është gjithsej **5,751** pasuri. Numri i pronave të paregjistruara zë një peshë prej **31,2%**. Nëse do të shtonim këtu edhe **4,7%** të pronave që janë regjistruar me Vërtetim nga dokumenti hipotekor, **pasuritë pa dokumentin ligjor** të vërtetimit të pronësisë, Certifikatën e pronësisë, shkon **39%** e numrit total të pronave (*Trajtuar më hollësisht në Pikë 6, faqe 64-79, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

31.1 Rekomandimi: Shoqëria duhet të marrë masa dhe t'i kushtojë një rëndësi të posaçme regjistrimit dhe certifikimit të pasurive të saj të patundshme në zyrat e kadastrave përkatëse duke zgjidhur sa më shpejt e me seriozitet të gjitha konfliktet e pronësisë me të tretët.

Brenda vitit 2019

32. Gjetje nga auditimi: Nga ana e KLSH nga auditimi për zbatimin e rekomandimeve nga auditimet e mëparshme, rezulton se KLSH me shkresën përcjellëse nr. 795/17, datë 09.01.2019 ka rekomanduar 106 masa, nga të cilat: 27 masa organizative, 18 masa zhdëmtimi me vlerën 387,496,886 mijë lekë, 20 masa të ardhura të munguara për shoqërinë, një masë e ardhur e munguar, 2 masa për dëm ekonomik pa mundësi llogaritje të plotë nga grupi i auditimit, 18 masa për eliminimin e efekteve negative dhe 20 masa disiplinore, (Mbështetur në Kodin e Punës). Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 27 masa organizative, nga të cilat, janë pranuar 26 masa dhe nga këto masa, janë zbatuar 4 masa, janë në proces 12 masa, nuk janë zbatuar 10 masa.

Konkretisht janë zbatuar rekomandimet nr. 5, 6, 8 dhe 10. Janë në proces zbatimi rekomandimet nr. 4, 13, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 27. Nuk janë zbatuar rekomandimet nr. 1, 2, 3, 7, 9, 11, 12, 14, 24, 25, 26.

b. Për shpërblim dëmi janë lënë 18 rekomandime në vlerën 387,496,886 mijë lekë nga të cilat 15 masa janë në proces, 1 masë është zbatuar plotësisht dhe 2 masa nuk janë zbatuar, konkretisht është zbatuar rekomandimi nr. 12, janë në proces zbatimi rekomandimet nr. 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 15, 16, 17, 18. Nuk janë zbatuar rekomandimet nr. 13 dhe 14.

-Nga 20 masa të ardhura të munguara për shoqërinë, nuk është zbatuar asnjë masë.

-Nga një masë e ardhur e munguar si rrjedhojë e një vendimi të padrejtë në vitin 2004, e cila duhet të analizohet, nuk është zbatuar.

-Janë 2 masa për dëm ekonomik pa mundësi llogaritje të plotë nga grupi i auditimit, nga të cilat të dy masat janë në proces zbatimi.

-Nga 18 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike, janë zbatuar plotësisht masa nr. 7 dhe 11, është në proces zbatimi rekomandimi nr. 8 dhe nuk janë zbatuar 15 masa.

Janë rekomanduar sipas Kodit të Punës 16 masa disiplinore, "Vërejte me shkrim" ose "Largim nga detyra" prej të cilave janë zbatuar 14 masa disiplinore (*Trajtuar më hollësisht në Pikë 1, faqe 10-24, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

32.1 Rekomandimi: Nga shoqëria Albpetrol SHA të merren masa për përsheptimin e realizimit të rekomandimeve në proces zbatimi. Të merren masa për realizimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme të KLSH-së, të cilat nga auditimet kanë rezultuar të pazbatuara, si dhe të ndiqen me vëmendje të posaçme ato të cilat janë në procese gjyqësore.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

33. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, sistemit të kontrollit të brendshëm dhe funksionimit të tij, u konstatua se në përgjithësi elementët e kontrollit të brendshëm nuk kuptohen nga njësia dhe janë të implementuara në shkallë shumë të ulët. Ky fakt provohet nga niveli i ulët i përputhshmërisë me kërkesat e manualit për

menaxhimin financiar për kontrollin, ku njësia nuk ka përpiluar pyetësorin e vetëvlerësimit dhe deklaratën e cilësisë së kontrolleve si bazë për vlerësimin e secilit komponent në kundërshtim me pikën 1, nenin 18 të Ligjit Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin Nr.10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar, dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010, Kap V, Shtojca 2.

-Për përbërësit e secilit komponent, nuk ka një rregullore të përditësuar për funksionimin administrativ në përshtatje të strukturës së ndryshuar, nuk janë përbushur plotësisht detyrimet në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale, për identifikimin dhe krijimin e Regjistrisë të Risqeve, objektivave të vendosura, strategjive të riskut, veprime të cilat vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive në kundërshtim me pikat 1 dhe 2 të nenit 9; nenit 10; pikën 3 gërma “d” të nenit 12; pikat 2 dhe 3 të nenit 16; dhe nenit 21 të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010, i ndryshuar, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” (*trajtuar më hollësisht në Pikë 11, faqe 118-120 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

33.1 Rekomandimi:- Nga AlbpetrolSHA të merren masa për të ngritur një sistem eficient të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimin financiar, si dhe të merren masa për krijimin e regjistrisë të riskut, gjurmëve të auditimit për veprimtaritë dhe proceset kryesore.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

34. Gjetje nga auditimi:- Kontrata e furnizimit “Blerje pompa centrifugale për QEMNG” është nënshkruar me OE “Q. S.” SHPK me datë 07.11.2018, me vlerë 2,292,000 lekë.

Për marrjen në dorëzim të pompave, sipas Urdhrit të administratorit nr. 12334 prot., datë 07.11.2018, është ngritur komisioni i përbërë nga z. S.Z., z. I.M, z. A.C, z. E.B, z. V.Sh, z. V.Xh, z. F.H, z. V.F dhe z. Dh.C. Me datë 21.01.2019, është mbajtur një akt teknik i cili është nënshkruar nga 5 anëtarë, ndërsa 4 të tjerë kanë paraqitur vërejtje. Anëtarët e komisionit të cilët nuk kanë nënshkruar aktin kanë paraqitur vërejtjet si më poshtë:

- Pompat nuk janë origjinale.
- Ka ndërhyrje në skemën e lidhjes së tyre.
- Ka vibrime të duzës dhe uji nuk ka njëtrajtshmëri.
- Largësia e hedhjes është e vogël.
- Pompa e autobotit është montuar ulët.

Nisur nga vërejtjet e paraqitura, anëtarët e komisionit z. S.Z, z. I.I, z. A.C, z. E.B, z. V.Sh, në kushtet kur është identifikuar që automjetet kenë qenë në gatishmëri dhe kanë realizuar me sukses fikje të zjarrit, duke funksionuar më mirë se mjetet e tjera, kanë vendosur:

- Shtyrjen e kohës së testimit të pajisjeve me 3 muaj.
- Realizimin e një marrëveshje me kontraktorin për një garanci 2 vjeçare.
- Në marrëveshje të përcaktohet që kontraktori ka detyrim që të kthejë skemën e montimit sipas pompave origjinale, nëse kërkohet nga autoriteti kontraktor.
- Duke qenë se disa anëtarë të komisionit nuk ishin dakord, i është kërkuar kontraktorit të garantojë funksionimin për dy vite, si dhe t’i përgjigjet të gjitha kërkesave të Albpetrol (*Trajtuar më hollësisht në Pikë 8, faqe 84-100, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

34.1-Rekomandimi:- “Albpetrol” SHA Patos, të caktojë një komision me specialistë dhe pa pjesëmarrjen e anëtarëve aktualë, për verifikimin e saktësisë së pajisjeve të furnizuara, funksionit të tyre dhe përshtatjen me specifikimet teknike, duke marrë edhe në konsideratë vështirësitë që mund të lindin në të ardhmen për rinovimin e tyre. Gjithashtu të nxirren përgjegjësitë për mos realizimin e plotë të detyrave të lëna për komisionin e kolauditimit dhe marrjes në dorëzim. Likuidimi i kontratës të bëhet vetëm pas përfundimit të këtij procesi.

C.1 MASA SHPËRBLIM DËMI

1-Gjetje nga auditimi: Këshilli mbikëqyrës ka marrë padrejtësisht karburant me kuota mujore 400 litra, e cila është në kundërshtim me Ligjin nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, neni 160; VKM nr. 642, datë 11.10.2005 “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore” i ndryshuar, pika 6 paragrafi i fundit; si dhe VKM nr.570, datë 03.10.2018 “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore” pika 6. Në këto kushte vlera e karburantit të marrë padrejtësisht nga anëtarët e këshillit mbikëqyrës **përbën dëm ekonomik për “Albpetrol” SHA në vlerën 477,440 lekë** (*Mëhollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 24-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1- Rekomandimi:- Administratori i Albpetrol SHA të marrë të gjitha masat e nevojshme administrative dhe të ndjekë të gjitha shkallët e gjyqësorit për arkëtimin e dëmit prej 477,440 lekë të shkaktuar nga anëtarët e këshillit mbikëqyrës si rezultat i përfitimit të padrejtë të karburantit, sipas trajtimit në Raportin përfundimtar të auditimit.

Menjëherë

2-Gjetje nga auditimi: Nga zbatimi i 25 kontratave të shitjes së gazit për vitin 2018 dhe janar-qershor 2019, **vlera prej 10,770,442 lekë**, e cila përfaqëson detyrime të pa likuiduara nga kontratat e gazit për vitin 2018 dhe janar-qershor 2019, llogaritur me çmimin e shitjes sipas përcaktimit në programin ekonomik, por që mund të shndërrohet në humbje nga vendosja e çmimit më të ulët në kontratën e furnizimit të gazit për subjektin “A.O.&G.” SHPK, konsiderohet dëm ekonomik shkaktuar buxhetit e Albpetrol SHA (*Trajtuar më hollësisht në Pikë 8, faqe 84-100, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1- Rekomandimi:- Administratori i Albpetrol SHA dhe Drejtori i QASHNG Patos të marrin masa për të velur detyrimet debitore nga kontratat e shitjes së gazit (sipas çmimit të miratuar) për vitin 2018 dhe janar-qershor 2019 në vlerën prej 10,770,442 lekë, duke nisur nga zgjidhja e kontratës dhe deri në procedim gjyqësor.

Menjë herë

3. Gjetje nga auditimi: Marrëveshja hidrokarbure për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Gorisht – Kocul e cila është rimarrë në administrim nga Albpetrol SHA në vitin 2017, nga inventarizimi rezulton se mungojnë asete në vlerën prej 65,634,660 lekë, të cilat përbëjnë dëm ekonomik për shoqërinë Albpetrol (*Trajtuar më hollësisht në Pikë 10, faqe 100-118, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1- Rekomandimi:- Administratori i Albpetrol SHA, Drejtorja e Marrëveshjeve Hidrokarbure dhe Drejtorja Juridike të marrin masat e nevojshme lidhur me rikuperimin e vlerës së aseteve të munguara në vlerën prej **65,634,660** lekë.

Brenda datës 31.10.2019

4. Gjetje nga auditimi: Në tenderin “Ndërtim tubacioni magjstral grupi Ca38-Ca17, në sektorin Cakran-Mollaj” kanë marrë pjesë 7 OE, nga të cilët për mungesë dokumentacioni janë skualifikuar 6 OE. Është shpallur fitues OE “B.” SHPK me vlerë oferte 15,537,751 lekë. Nga verifikimi i dokumentacionit në sistemin elektronik të APP rezulton se BOE “H.” SHPK dhe “Sh.A.” SHPK janë skualifikuar me argumentin: “Nuk ka paraqitur dokumentacion për të gjitha mjetet e kërkuara sipas pikës 2.3, kapaciteti teknik, germa d”. Nuk është cilësuar se cila nga makineritë nuk është në përputhje me dokumentet e tenderit.

Në makineritë e paraqitura nga OE “B.” SHPK, autoboti është një kamion me një cisternë të vendosur mbi kamion, por jo autobot.

Nga auditimi i dokumentacionit në rrugë elektronike rezulton se BOE “‘H.’ dhe ‘Sh. A.’” SHPK, kanë paraqitur dokumentacion të rregullt për të gjitha makineritë sipas kërkesave të dokumenteve të tenderit dhe në këto kushte ky OE duhet të kualifikohej dhe të propozohej për nënshkrimin e kontratës.

Diferenca e ofertës së paraqitur nga BOE “‘H.’ dhe ‘Sh. A.’” SHPK, me ofertën e paraqitur nga OE fitues “B.” SHPK, me vlerë 2,523,484 lekë (15,537,751 lekë-13,014,267 lekë), përbën dëm ekonomik.

Nga ballafaqimi i realizuar me z. B.L datë 29.07.2019, në cilësinë e kryetarit të komisionit pretendohet se:

- Operatori Ekonomik “H.” SHPK nuk ka paraqitur automjet me vinç.
- Gjeneratori i paraqitur nuk ka faturë tatimore.
- OE ka paraqitur vetëm një motosaldatrice nga dy të kërkuara.

Nga rishqyrtimi i dokumentacionit rezulton se automjeti i paraqitur është me vinç, kjo e vërtetuar nga fotografitë, por dhe nga dokumentacioni i mjetit. OE ka paraqitur automjetin me targë AA...., dokumenti i pronësisë të të cilit me nr. FRD0549114, lëshuar me datë 30.04.2014 nga DPSHTRR Fier, e paraqet me përshkrimin “kamion me vinç të montuar”.

Sa i përket gjeneratorëve, OE ka paraqitur kontratën noteriale nr. 11238 rep, nr. 3718 kol të datës 27.12.2005, për blerjen e dy gjeneratorëve, nga subjekti shitës z. V.D.

Sa i përket motosaldatriçeve theksojmë se, OE ka paraqitur një motosaldatriçe të blerë me faturë tatimore nr. 21395049, 2 motosaldatrice sipas deklaratës noteriale nr. 9122 Rep. datë 06.08.2009, shoqëruar me faturë tatimore blerje nr. 02143234, datë 31.05.2009. Në këtë faturë janë përfshirë gjithashtu dy saldaqtrice me oksigjen.

Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 46, pika 1 (*Trajtuar më hollësisht në Pikë 8, faqe 84-100, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1 -Rekomandimi: - Nga “Albpetrol”SHA, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimi i vlerës 2,523,484 lekë**, nga anëtarët e KVO z. B.L, znj. R.G dhe z. S.H, për skualifikim dhe kualifikim të padrejtë të OE.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Komisioni teknik për kolaudimin dhe marrjen në dorëzim të mallit objekt i kontratës “Blerje kabull fuqie” është ngritur sipas Urdhrit nr. 12881/13, datë 05.04.2019, i përbërë nga z. V.Gj, z. L.I dhe z. A.C.

Me datë 13.06.2019, u verifikuan materialet e furnizuara në magazinën e QFT. Nga verifikimi rezultoi se nuk ishte furnizuar kabulli i tensionit të mesëm sipas zërit 22 “Kabëll TM 3 x 50/6 kv”, në gjatësisë 100 ml. Në vend të këtij kabulli, kontraktori ka bërë furnizimin me kabull me një fije, i cili jo vetëm nuk i përshtatet specifikimeve, por nuk kryen qëllimin e përcaktuar.

Vlera 156,000 lekë[(100 ml x 1,300 lekë) + TVSH], është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori “V.” SHPK dhe përbën dëm ekonomik (*Trajtuar më hollësisht në Pikë 8, faqe 84-100, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1. Rekomandimi: - “Albpetrol” SHA Patos, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimi i vlerës 156,000 lekë**, nga Kontraktori “V.” SHPK, vlerë e cila është përfituar padrejtësisht, si pasojë e furnizimeve jo në përputhje me specifikimet teknike.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi:- Kontrata e furnizimit “Blerje pompa centrifugale për QEMNG” është nënshkruar me OE “Q. S.” SHPK me datë 07.11.2018, me vlerë 2,292,000 lekë. Afati i zbatimit është përcaktuar 20 ditë. Bazuar në aktin e marrjes në dorëzim, komisionit i është bërë e mundur verifikimi i pompave me datë 08.01.2019, ose 10 ditë me vonesë. Sa më sipër, bazuar në nenin 9 të kontratës, Kontraktori “Q.S.” duhet të penalizohet për vonesa në dorëzim me **vlerë 77,200 lekë** (1,930,000 lekë x 4/1000 x 10 ditë) (*Trajtuar më hollësisht në Pikë 8, faqe 84-100, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1-Rekomandimi:- Nga “Albpetrol”SHA, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i **vlerës 77,200 lekë**, nga Kontraktori “Q.S.”, për dorëzim të vonuar të furnizimit.

Menjëherë

C. 2. DËM EKONOMIK - TË ARDHURA TË MUNGUARA

1. Gjetje nga auditimi: Bazuar në të dhënat në dispozicion, për periudhën e zbatimit të marrëveshjes hidrokarbure për zonën Patos-Marinëzjanë krijuar detyrime për pjesën e prodhimit PPE dhe ASP duke filluar nga viti 2011. Bazuar në çmimet e shitjes së naftës nga Kontraktori dhe çmimet e shitjes në momentin e likuidimit të këtyre sasive, *Albpetrol SHA, ka pësuar humbje me vlerë 6,670,842 USD, ose 728,189 mijë lekë*, nga të cilat për vitin 2018, afërsisht 1,741,840 USD. Kjo vjen si pasojë e likuidimit të naftës brut jo në periudhën e lindjes së detyrimit, periudhë në të cilën çmimet e naftës brut në bursa ishin të favorshme (po ashtu çmimet me të cilat Kontraktori i ka shitur këto sasi), krahasuar me çmimet me të cilat është shitur kjo naftë e likuiduar për llogari të Albpetrol në vitet e fundit (2017-2018, periudhë në të cilën Kontraktori ka dhënë për Albpetrol sasinë 50.8 mijë ton nga detyrimet e viteve të mëparshme). Sasia e mësipërme është likuiduar në natyrë, pasi kontraktori nuk ka pranuar të shlyejë detyrimet në vlerë.

- Kontraktori deri në fund të vitit 2018, i ka detyrim Albpetrol Sasinë 31,629 ton naftë brut, e cila është krijuar kryesisht në vitin 2011. Sa i përket kësaj sasive është hapur një proces arbitrazhi, i cili nuk ka përfunduar ende.

Për vitin 2019 është rritur detyrimi për sasinë **150.23 ton**, ose shprehur në vlerë (çmimi dhjetor 2018), në shumën **49,580 USD**.

Në marrëveshjen hidrokarbure nuk është parashikuar mundësia e krijimit të detyrimeve nga Kontraktori, rrjedhimisht as sanksione për veprime të tilla (*Trajtuar më hollësisht në Pikë 10, faqe 100-118, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1-Rekomandimi: Albpetrol SHA, duhet të kërkohet në mënyrë të vazhdueshme nga Kontraktori në marrëveshje, shlyerjen e detyrimeve përkatëse. T’i kërkohet Kontraktorit të shlyejë dëmin me vlerë **6,670,842 USD**, ose **728,189 mijë lekë** ndaj Albpetrol, pasi vonesa ka ardhur për arsye të vetë Kontraktorit.

Menjëherë dhe vazhdimisht

2. Gjetje nga auditimi:- Albpetrol SHA me shkresë nr. 2847 prot., datë 29.03.2019, i është drejtuar Kontraktorit dhe për dijeni Ministrisë dhe AKBN, në lidhje me auditimin e llogarive të Kontraktorit për raportet 3-mujore nr. 1, 2, 3 dhe 4 të vitit 2015, realizuar sipas njoftimit për auditim nr. 701 prot., datë 08.01.2018. Bazuar në këtë shkresë, i është kërkuar kontraktorit zbritja nga kostot hidrokarbure të vlerës **97,981,667 USD**.

Bazuar në nenin 25 “Auditet” të Marrëveshjes Hidrokarbure, Albpetrol SHA ka zhvilluar procesin e auditimit të njoftuar me shkresën nr. 7601 prot., datë 15.11.2017, me Lëndë “Njoftim fillim proces auditimi për periudhën Q1, Q2, Q3 2017”.

Nga auditimi ka rezultuar që për periudhën janar-shtator 2017, janë përfshirë në kosto hidrokarbure shpenzime në kundërshtim me marrëveshjen hidrokarbure me vlerë **46,211,029 USD**.

Shpenzimet e përfshira në kosto hidrokarbure në kundërshtim me marrëveshjen, kanë të bëjnë kryesisht me:

Materiale të cilat nuk janë përdorur por deklarohen gjendje magazinimi.

Shpenzime administrative mbi 250,000 USD, jashtë vendit.

Përfshirja në kosto hidrokarbure dëmshpërblimi për zgjidhjen e konfliktit me një kompani tjetër (trajtuar edhe në auditin e KLSH 2016).

Shpenzime transport mbi buxhetin e miratuar.

Detyrimet të ndërsjella të Kontraktorit me nënkontraktorë si A. dhe D.

Shpenzime për qira toke, pagesa për shërbime të pa përfshira në kontratat me të tretë, pa dokumentacion justifikues etj.

Pas zbritjes së kostove hidrokarbure në kundërshtim me marrëveshjen me vlerë 144,192,696 USD (97,981,667 USD + 46,211,029 USD), koeficienti R rezulton mbi 1 dhe bazuar në Nenin 9.2 të Marrëveshjes Hidrokarbure, kontraktori (duke zbritur vetëm vlerën e mësipërme, pasi vlera të tjera janë në proces arbitrazhi), *i detyrohet buxhetit të shtetit vlerën 17,214,348 USD [(3,330,433,000-3,296,004,304)/2]*. Po ashtu, Kontraktori i detyrohet Albpetrol masën 3 % të prodhimit dhe jo 1 %, e cila pas llogaritjeve rezulton në sasinë 82372 ton [(33323.5 + 7862.7) ton x 2], e cila referuar çmimit në bursë për vitin 2018 shprehur në vlerë 27,185,231 USD (82372 ton x 330.03 USD/ton).

Sa më sipër, vlera 44,399,579 USD (17,214,348 USD + 25,237,256), përbën të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit dhe buxhetin e shoqërisë.

Nga ana e Albpetrol janë audituar edhe llogaritë kosto hidrokarbure të kontraktorit për 3 mujorin e 4 të vitit 2017 (*Trajtuar më hollësisht në Pikë 10, faqe 100-118, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1 -Rekomandimi:-Albpetrol SHA, duhet t’i kërkojnë Kontraktorit zbritjen e shpenzimeve të përfshira në koston hidrokarbure në kundërshtim me marrëveshje hidrokarbure me vlerë 144,192,696 USD. Pas zbritjes së kësaj vlere (duke shtuar edhe shpenzimet për 3 mujorin e 4 të vitit 2017), të rillogaritet Koeficienti R, i cili për gjysmën e fitimit të krijuar i detyrohet Qeverisë Shqiptare vlerën **17,214,348 USD, ose 1,879,118 mijë lekë** dhe “Albpetrol” SHA sasinë 82372 ton naftë brut, ose vlerën **27,185,231 USD**.

2.2 –Rekomandimi:-Nga ana e Albpetrol SHA, të merren masa për auditimin e llogarive të koston hidrokarbure të raportuara nga Kontraktori edhe për vitin 2018 dhe në vazhdimësi.

Në mbledhjen e radhës së ACM

3. Gjetje nga auditimi: Kontraktori sipas marrëveshjes hidrokarbure me Kompaninë “Sh. I. Ltd” në vazhdimësi ka krijuar detyrime ndaj Albpetrol për sasinë e naftës brut, nga ndarja e prodhimit. Deri në fund të 3 mujorit I, të vitit 2019, kontraktori i detyrohet Albpetrol SHA sasinë 81.59 ton naftë brut, ose shprehur në vlerë në shumën **26,929 USD**.

Bazuar në shkresën e Albpetrol nr. 5630/2 prot., datë 12.06.2019, rezulton se Kontraktori i detyrohet Albpetrol për llogari të bonuseve të trajnimit vjetor **vlerën 151,586 USD** (*Trajtuar më hollësisht në Pikë 10, faqe 100-118, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1-Rekomandimi:-Albpetrol SHA, duhet të kërkojnë në mënyrë të vazhdueshme nga Kontraktori në marrëveshje, shlyerjen e detyrimeve përkatëse. T'i kërkohet Kontraktorit të shlyejë detyrimin në sasi 81,59 ton naftë brut, vlerë 26,929 USD, ose **2,939 mijë lekë** si dhe të marrë masa për zhvillimin e trajnimeve, për të cilat është parashikuar vlera 151,586 USD, ose 16,547 mijë lekë.

Në mbledhjen e radhës së ACM

4. Gjetje nga auditimi:Nga ana e Albpetrol është realizuar auditim i llogarive të kostos hidrokarbure për vitin 2017. Auditimi është njoftuar me shkresë nr. 3665 prot., datë 24.04.2018. Po me këtë shkresë është kërkuar zbritja e shpenzimeve të përfshira në kosto hidrokarbure si më poshtë:

Fatura pagese pa asnjë dokumentacion.

Fatura për raporte monitorimi, ndërkohë që nuk ka raporte të tilla.

Fatura shërbimi pa asnjë kontratë të nënshkruar.

Fatura furnizim hekuri, furnizim i cili nuk është i përfshirë në kontratën përkatëse etj.

Kontraktori ka përfshirë në kostot hidrokarbure shpenzime në kundërshtim me marrëveshjen hidrokarbure me vlerë 351,514 USD, vlerë e cila duhet të zbritet nga kjo llogari, duke rishikuar koeficientin R. Për transaksionet e deklaruara nuk mbahet dokumentacion si dhe konstatohet se përfshihen elementë të cilët nuk janë të përcaktuara në kontratat me nënkontraktorët për shërbime të ndryshme, veprime në kundërshtim me Shtojcën B, Pika 2.1, të ndryshuar, të marrëveshjes hidrokarbure (*Trajtuar më hollësisht në Pikë 10, faqe 100-118, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1 Rekomandimi: - Albpetrol SHA, duhet t'i kërkojnë Kontraktorit zbritjen e shpenzimeve të përfshira në kostot hidrokarbure në kundërshtim me marrëveshje hidrokarbure me vlerë **351,514 USD, ose 38,371 mijë lekë**dhe ri llogaritjen e koeficientit R.

Në mbledhjen e radhës së ACM

5. Gjetjengaauditimi: Nga shqyrtimi i marrëveshjeve hidrokarbure konstatohet se për periudhën objekt auditimi, mosrealizimi i detyrimeve të kontraktorëve ndaj Albpetrol SHA për Prodhimin Para Ekzistues (PPE) dhe Pjesa e Prodhimit për Albpetrol-in (PPA) është në vlerën prej 2,580,737 USD, e ndarë si më poshtë:

-Në periudhën tremujori i tretë 2018 – tremujori i parë 2019 (mungojnë të dhënat për tremujorin e dytë 2019 i cili është pjesë e periudhës së auditimit) janë 8018 ton naftë brut që "A. O.&G." SHA i detyrohet Albpetrol SHA për PPE dhe PPA, sasi prodhimi që përfaqëson vlerën prej **2,435,218USD** e cila përbën të ardhura të munguara për Albpetrol SHA.

-Kontraktori T. O. S. SHA i detyrohet Albpetrol SHA, për deficitin e krijuar prej 564.28 ton naftë brut, e cila vlerësuar me çmimin përkatës është në vlerën **145,519.42 USD**, ose 15,884 mijë lekë, e cila e cila përbën të ardhura të munguara për Albpetrol SHA.

Të ardhurat e munguara në shumën e mësipërme kanë ulur efektivitetin e veprimtarisë së Albpetrol SHA, për më tepër që detyrimet progresive janë akoma dhe më të mëdha (*Trajtuar më hollësisht në Pikë 10, faqe 100-118, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1 Rekomandimi: Administratori dhe Drejtoria e Marrëveshjeve të vazhdojnë përpjekjet për të rikuperuar detyrimet e kompanive që rrjedhin nga marrëveshjet hidrokarbure për PPE dhe PPA, duke dokumentuar këtë korrespondencë, si dhe duke i bërë objekt diskutimesh dhe debati në të gjitha rastet e mbledhjeve të Komitetit Këshillimor.

Vazhdimisht

6. -Gjetjengaauditimi: Gjatë zbatimit të Marrëveshjes hidrokarbure për vendburimin Visokë, kontraktori T. O. S. SHA ka krijuar detyrime financiare për shërbimet e ofruara nga Albpetrol SHA deri më 31.03.2019 në vlerën prej **58,809,774** lekë, lidhur me shërbimet me agregatë, faturat e energjisë elektrike etj., të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për shoqërinë. Mungesa e kësaj vlere ka sjellë si pasojë uljen e efektivitetit të përdorimit të fondeve publike të Albpetrol SHA (*Trajtuar më hollësisht në Pikë 10, faqe 100-118, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1 Rekomandimi: Administratori, Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Financës të bëjnë një analizë të hollësishme mbi situatën e krijuar, duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse, për të gjitha shërbimet e kryera por të pa likuiduara nga Albpetrol SHA ndaj kontraktorëve të marrëveshjeve; të vazhdojë përpjekjet për vjeljen e këtyre detyrimeve, si dhe të marrë masa për mos përsëritjen e tyre.

Vazhdimisht

C. 3 MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICIENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Për periudhën e auditimit gusht 2018 qershor 2019 kompania ka kryer shpenzime në vlerën 154,070,279 lekë në zërin shpërblime në vlerën totale të 201,896,827 lekë nga të cilat 154,272,175 lekë janë të justifikuara dhe të parashikuara në program pasi janë shpenzime për vjetërsi pune dhe për punonjësit e planifikuar për t'u larguar. Shpenzimet në vlerën 154,070,279 lekë janë shpenzime të pajustificuara, të paparashikuara në planifikimin e miratuar nga MIE për vitin 2018, ku është rishikuar programi i zhvillimit ekonomik të Shoqërisë për vitin 2018, të aprovuara nga Këshilli Mbikëqyrës. Këto shpenzime janë të pa mbështetura në ligj ndaj ato konsiderohen efekt negativ financiar (*Trajtuar më hollësisht në Pikë 3, faqe 28-36, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1 Rekomandim: Këshilli Mbikëqyrës, Administratori i Shoqërisë, Drejtoria e Financës së Shoqërisë, duhet të marrin masa shqyrtimin e vlerës së mësipërme rast pas rasti, duke shmangur praktika të tilla në të ardhmen.

Deri në 31 dhjetor 2019

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i listë pagesave të pagave në natyrë (dietave) për muajt gusht 2018-01 korrik 2019, rezulton se është paguar në masën 500 lekë në ditë për të gjithë punonjësit e Shoqërisë, me një vlerë prej **221,019,661** lekë në total. Sipas VKM nr. Nr. 68, datë 7.2.2018 “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfutur në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore”, pika 2, germa a), kjo dietë është caktuar në masën **300** lekë në muaj ose shprehur në vlerë në shumën **132,611,796** lekë.

Diferenca në vlerë **88,407,864** lekë (221,019,661 – 132,611,796) konsiderohet efekt negativ financiar negativ në përdorimin e fondeve (*Trajtuar më hollësisht në Pikë 3, faqe 28-36, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1 Rekomandim: Këshilli Mbikëqyrës, Administratori i Shoqërisë, Drejtoria e Financës së Shoqërisë, duhet të marrin masa shqyrtimin e vlerës së mësipërme rast pas rasti, duke shmangur praktika të tilla në të ardhmen nëpërmjet harmonizimit të akteve legislative përkatëse (Ligj, VKM, Kontratën Kolektive të punësimit dhe Kontratë Individuale).

Deri në fund të vitit 2019

3. Gjetje nga auditimi: Për periudhën e auditimit gusht 2018 qershor 2019 janë hapur rreth **125** çështje gjyqësore kundër shoqërisë nga të cilat ka vendim të ndërmjetëm për 62 çështje nga të cilat **32** janë humbur dhe **30** janë fituar në shkallët e ulta të gjykimit nga *Albpetrol sha* dhe për **62** kërkesa çështja është në proces në shkallë të parë të gjykimit, pa vendim.

Për **5 muajt e fundit të vitit 2018** Shoqëria ka shpenzuar **prej humbjes së një numri të konsiderueshëm gjyqesh (30 çështje)** me punëmarrësit e shkarkuar, duke shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën **54,985,953** lekë, ku përfshihen edhe shpenzimet përmbartimore. Ndërsa përsa i takon gjashtëmujorit të parë të vitit 2019, shoqëria ka shpenzuar nga humbja e çështjeve gjyqësore (**68 çështje**) me punëmarrësit e shkarkuar, **44,674,086** lekë. Pra, për të gjithë periudhën e auditimit, **nga humbja e proceseve gjyqësore dhe me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë prej kompanive përmbartimore, Shoqëria Albpetrol Sha ka humbur gjithsej 99,660,039 lekë** (54,985,953 + 44,674,086) si rezultat i shkeljes së pikës G/1/5 dhe I/1/10 të Rregullores së Brendshme të Shoqërisë me nr.1357 dt.22.04.2013 (*Trajtuar më hollësisht në Pikë 3, faqe 28-36, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1 Rekomandim: Strukturat drejtuese të Shoqërisë duhet të punojnë më mirë në të ardhmen për të hartuar e përditësuar kontratat individuale dhe kolektive të punësimit dhe marrëdhëniet me sindikatat, gjithë procedurën e konkurrimit dhe rekrutimit të punonjësve në përputhje me legjislacionin në fuqi si edhe të ndjekin me përparësi çdo çështje gjyqësore në të gjithashkallët e gjykimit me ishpunonjësit e saj, për të minimizuar humbjet nga shpenzimet për vendimet gjyqësore të formës së prerë në favor të punonjësve të larguar.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

4. Gjetje nga auditimi: Gjatë 5 mujorit të fundit gusht-dhjetor 2018 në kompani duhet të kishte një shkurtrim prej 584 punonjësish. Referuar Vendimit nr. 27 datë 24.12.2018, të Këshillit Mbikëqyrës gjatë këtij 5 mujori ka pasur në total rreth **267** punonjës më tepër nga planifikimi me efekt financiar negativ prej **12,168,259** lekë në financat e kompanisë duke marrë parasysh pagën mesatare prej **45,574** lekë (267 x 45,574). Ndërsa në gjashtëmujorin e parë të vitit 2019, referuar Strukturës aktuale organizative të Shoqërisë Albpetrol SHA të miratuar me Vendimin nr.328, datë 14.01.2019 të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë (MEI), ka pasur gjithsej **29** punonjës më shumë nga parashikimi duke sjellë një efekt negativ financiar prej **1,465,747** lekë, duke marrë parasysh pagën mesatare prej 50,543 lekë (29 x 50,543). Në periudhën e auditimit, ky efekt negativ total është në vlerën **13,634,006** (12,168,259 + 1,465,747) lekë (*Trajtuar më hollësisht në Pikë 3, faqe 28-36, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë, Drejtoria e Personelit dhe drejtoria Jurisike, të marrin masa për zbatimin e strukturës organike të miratuar, në zbatimin me rigorozitet të programit të punësimit dhe programit ekonomik-financiar që tëmbajë në punë numrin e parashikuar të punonjësve për të mos shkaktuar efekte negative nga shpenzimet e paparashikuara me fondin e pagave.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Aktualisht sistemi “*Program kompjuterik për menaxhimin e magazinave dhe pajisja e tyre me barcode*” nuk përdoret nga stafi i Albpetrol. Veprimet e hyrje daljeve të aseteve vazhdojnë të kryhen njësoj si para marrjes së sistemit, manualisht. Situata e krijuar në lidhje me mosvënien në përdorimit të sistemit, nuk e justifikon investimin e bërë prej **19,550,000 lekë** pa TVSH. Si pasojë e mospërdorimit të sistemit, e gjithë vlera e shpenzuar për këtë sistem përbën **përdorim pa efektivitet të fondeve**.

Në kundërshtim me Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në Pikë 8, faqe 84-100, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1 -Rekomandimi: - Administratori dhe Sektori i IT i Alpetrol SHA të marrë masat për vënien në përdorim të sistemit “*Program kompjuterik për menaxhimin e magazinave dhe pajisja e tyre me barcode*”, i cili i ka kushtuar shoqërisë **19,550,000 lekë**.

Brenda periudhës së garancisë

6. Gjetje nga auditimi: - Nga verifikimi analitik i zërave të specifikimeve teknike të kontratës “*Zhvillim dhe mirëmbajtje të infrastrukturës mbështetëse të sistemeve IT*”, u konstatua:

- Pika 2.1 “Garanci për suport për EMC Storage ekzistues” dhe pika 2.2 “Garanci për suport për CiscoServers dhe pajisjet CiscoNetworking ekzistuese”, janë të pabazuara ligjërisht. Suportipër pajisjet hardwer-ike nuk janë të parashikuara në legjislacionet e sistemeve të informacionit. Në opinion të grupit të auditimit, ky zë nuk duhej të ishte parashikuar. Për pasojë vlera totale e dy zërave të mësipërm **2,593,959 lekë pa TVSH përbën përdorim pa efektivitet të fondeve**.

- Pikat 4.1 “Dizajni i ri, zhvillim dhe migrim i përmbytjes aktuale të faqes Web” dhe pika 4.2 “Shërbim instalimi dhe konfigurimi të software dhe hardware” janë llogaritur mbi bazë ditore, saktësisht 20 ditë x vlerën përkatëse ditore në lekë. Në opinion të grupit të auditimit, këto dy pika duhet të jenë “LampSum”, pasi nuk mund të llogariten në sasi ditore. Për pasojë vlera totale e dy zërave të mësipërm **1,939,180 lekë pa TVSH përbën përdorim pa efektivitet të fondeve**.

Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi R.L, në cilësinë e personit të ngarkuar për hartimin e specifikimeve teknike.

Në kundërshtim me Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në Pikë 8, faqe 84-100, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1 -Rekomandimi: -Nga Administratori i Alpetrol SHA të analizohet vlera **4,533,139 lekë**, e cila për Alpetrol SHA përbën përdorim pa ekonomikitet, efikasitet dhe efience të fondeve, si dhe të marrë masat që në vijimësi të tregohet kujdes maksimal në prokurimin e zërave të kontratave në fushën e teknologjisë së informacionit.

Brenda datës 30.10.2019

7. Gjetje nga auditimi:- Në preventivin e përgatitur nga z. A.B është përlllogaritur pesha e tubit me parametra (Dn 168.3 mm, spesor 6.3 mm, gjatësi 2728 mm), në sasinë 77.2 ton, ndërkohë që nga ribërja e llogaritjeve pesha përkatëse rezulton 68.6 ton. Në preventivin e sistemit është hedhur tubacion me spesor 7.1 mm, por në specifikimet teknike (sistemi elektronik i prokurimeve), përsëri është përcaktuar tubacion më spesor 6.3 mm. Çmimi i paraqitur në ofertë për zërin e mësipërm është 185,857 lekë për ton. Në këto kushte, është parashikuar më tepër vlera 1,292,408 lekë [(77.2-68.6) ton x 150,280 lekë]. Në total, fondi limit është rritur në mënyrë të pa argumentuar **me vlerë 1,292,408 lekë, vlerë e cila përbën efekt negativ financiar** (*Trajtuar më hollësisht në Pikë 8, faqe 84-100, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1 -Rekomandim:- Nga ana e komisionit të përlllogaritjes së fondit limit duhet të vendosen referenca të bazuara në koston reale, për blerjen e shërbimeve, mallrave dhe punimeve, me kosto sa më të përshtatshme në interes të institucionit. Sa i përket vlerës 1,292,408 lekë, gjatë zbatimit të kontratës, nga ana e mbikëqyrësit të punimeve duhet të bëhen verifikimet e nevojshme në lidhje me dimensionet e tubacioneve të furnizuara dhe analizimit të efekteve

qëkanë ardhur si pasojë e mos përcaktimit të saktë të dimensionit të tubave në specifikime teknike dhe preventiv.

Vazhdimisht

8. -Gjetje nga auditimi: Në përlllogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit tender i hapur “Blerje uniforma pune për punonjësit”, grupi i punës me veprimet dhe mosveprimet e tij nuk ka harmonizuar alternativat dhe nuk ka zbatuar me përpikmëri nenin 59 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, duke shkaktuar rritjen e paargumentuar të kostos për këtë procedurë prokurimi prej **2,171,910 lekë**. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 84-100, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

8.1- Rekomandimi:- Administratori i shoqërisë, në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor të marrë masa për trajnimin e zyrtarëve të prokurimit dhe monitorimin e tyre, me qëllim ezaurimin e plotë dhe të saktë të alternativave të mundshme të përcaktimit të fondit limit, me qëllim maksimizimin e efektivitetit të përdorimit të fondeve publike.

Vazhdimisht

9. Gjetje nga auditimi: Komisioni teknik për kolaudimin dhe marrjen në dorëzim të gomave në procedurën e prokurimit Kërkesë për propozim me mjete elektronike “Blerje goma automjetesh”, ka marrë 9 artikuj me vlerë **1,067,000 lekë** të prodhuara mbi 6 muaj nga data e furnizimit në kundërshtim me specifikimet teknike të kontratës *(Trajtuar më hollësisht në Pikë 8, faqe 84-100, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

9.1- Rekomandimi:- Administratori i shoqërisë të ngrejë një grup pune për verifikimin e dëmit të shkaktuar shoqërisë dhe evidentimin e përgjegjësisë, për shkak të marrjes së mallit me cilësi jashtë specifikimeve teknike, si dhe të shmangë përsëritjen e rasteve të tilla, duke vendosur zyrtarë të prokurimeve persona të trajnuar për këtë qëllim.

Brenda datës 30.10.2019

D. MASA DISIPLINORE

Bazuar e në referim të nenit nr. 37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, si Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 31, datë 13.06.2014 “Për unifikimin e kontratave individuale të punës” neni 13, Pika 2 dhe 3, kërkojmë nga Administratori i Shoqërisë fillimin e procedurave për dhënie masë disiplinore, si më poshtë:

I. “Largim nga puna” për:

1. z. A.P, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Shërbimit dhe Furnizimit,

2. z. E.B, me detyrë Specialist në Drejtorinë e Shërbimit dhe Furnizimit, për arsye se:

- Në cilësinë e grupit të punës të përlllogaritjes së fondit limit me veprimet dhe mosveprimet e tyre nuk kanë harmonizuar alternativat dhe nuk kanë zbatuar me përpikmëri nenin 59 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, duke shkaktuar rritjen e paargumentuar të kostos për këtë procedurë prokurimi në vlerën prej 2,171,910 lekë, për procedurën e prokurimit tender i hapur “Blerje uniforma pune për punonjësit”.

3. z. A.D, me detyrë inxhinier mekanik,

4. z. L.I, me detyrë kolaudator,

5. z. A.C, me detyrë jurist, për arsye se:

- Në cilësinë e Komisionin teknik për kolaudimin dhe marrjen në dorëzim në procedurën e prokurimit Kërkesë për propozim me mjete elektronike “Blerje goma automjetesh”, sipas dokumenteve të pagesës rezultoi se 9 artikuj me vlerë prej 1,067,000 lekë nuk janë në përputhje me specifikimet teknike, pasi janë prodhuar së paku 8 muaj më parë nga lëvrimi i mallit nga 6 muaj në specifikimet teknike, duke sjellë efekt financiar negativ për shoqërinë Albpetrol si dhe një pjesë të kësaj vlere dëm ekonomik.

6. z. B.L,

7. znj. R.G,

8. z. S.H, në cilësinë e anëtarëve të KVO, për arsye se:

Në procedurën e prokurimit “Ndërtim tubacioni magjistral grupi Ca38-Ca17, në sektorin Cakran-Mollaj” kanë skualifikuar padrejtësisht një OE dhe kanë kualifikuar një OE i cili ka mangësi, veprim sipas të cilit është shkaktuar dëm ekonomik me vlerë 2,523,484 lekë.

II. “Vërejte me shkrim me paralajmërim për pushim nga puna” për:

1.znj. R.B në cilësinë e Sekretares së Këshillit Mbikëqyrës, duke njoftuar për këtë qëllim institucionin përkatës të punësimit, për arsye se:

-Në mbledhjen e datës 30.01.2019 tre vendimet e marra që kanë të bëjnë me ndryshimin e statutit, ndryshimin e Rregullores së brendshme dhe miratimin në parim të transferimit të një prone në Bashkinë Patos, nuk janë firmosur nga Kryetari z. G.Ll dhe anëtari z. K.B. Një vendim marrje e tillë është në kundërshtim me ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, neni 2, pika 2;

-Janë marrë vendimi qarkullues nr.6/1 datë 21.03.2019 për miratimin e pjesëmarrjes së administratorit në programin e kualifikimit profesional, si dhe nr. 12, datë 25.04.2019 për emërimin në detyrë të z. E.Sh dhe z. B.M si specialistë në Drejtorinë e auditit të brendshëm të shoqërisë “Albpetrol”. Një veprimtari e tillë është në kundërshtim me ligjin nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, neni 161, pika 3, si dhe në kundërshtim me ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, neni 16, pika 1;

2. z. R.L, në cilësinë e hartuesit të specifikimeve teknike, për arsye se:

-Në cilësinë e hartuesit të specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me objekt: “Zhvillim dhe mirëmbajtje të infrastrukturës mbështetëse të sistemeve IT”:

- ka vendosur specifikime teknike në kundërshtim me Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, specifikime të cilat kanë ndikuar negativisht në pjesëmarrjen e gjerë të operatorëve ekonomik.

- ka vendosur zëra të cilat në opinionin e grupit të auditimit janë të panevojshme, duke krijuar efekt financiar negativ për AlbpetrolShA në vlerën 2,593,959 lekë pa TVSH.

- ka vendosur zëra duke i llogaritur mbi bazë ditore, ndërkohë natyra e tyre është “Lump Sam”, duke shkaktuar përdorim pa efektivitet të fondeve në vlerën 1,939,180 lekë.

2. Në cilësinë e anëtarit të komisionit të marrjes në dorëzim në procedurën e prokurimit me objekt: “Zhvillim dhe mirëmbajtje të infrastrukturës mbështetëse të sistemeve IT”, ka marrë

në dorëzim sistemet e kërkuara, të cilat nuk i përmbushnin plotësisht kërkesat e bëra në specifikimet teknike.

3. z. G.L, në cilësinë e punonjësit IT, për arsye se:

- Në cilësinë e anëtarit të komisionit të marrjes në dorëzim në procedurën e prokurimit me objekt: “Zhvillim dhe mirëmbajtje të infrastrukturës mbështetëse të sistemeve IT”, ka marrë në dorëzim sistemet e kërkuara, të cilat nuk i përmbushnin plotësisht kërkesat e bëra në specifikimet teknike.

- Në cilësinë e anëtarit të komisionit të marrjes në dorëzim në procedurën e prokurimit me objekt: “Program kompjuterik për menaxhimin e magazinave dhe pajisja e tyre me barcode”, ka marrë në dorëzim sistemin e kërkuar, i cili nuk i përmbushnin plotësisht kërkesat e bëra në specifikimet teknike.

4. z. R.Sh, në cilësinë e hartuesit të specifikimeve teknike, për arsye se:

Në procedurën e prokurimit me objekt: “Program kompjuterik për menaxhimin e magazinave dhe pajisja e tyre me barcode”:

- ka vendosur specifikime teknike në kundërshtim me Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, specifikime të cilat kanë ndikuar negativisht në pjesëmarrjen e gjerë të operatorëve ekonomik.

- Në cilësinë e anëtarit të komisionit të marrjes në dorëzim në procedurën e prokurimit me objekt: “Program kompjuterik për menaxhimin e magazinave dhe pajisja e tyre me barcode”, ka marrë në dorëzim sistemin e kërkuar, i cili nuk i përmbushnin plotësisht kërkesat e bëra në specifikimet teknike.

5. znj. B.H, në cilësinë e anëtares së komisionit të marrjes në dorëzim,për arsye se:

- Në procedurën e prokurimit me objekt: “Zhvillim dhe mirëmbajtje të infrastrukturës mbështetëse të sistemeve IT”, ka marrë në dorëzim sistemet e kërkuara, të cilat nuk i përmbushnin plotësisht kërkesat e bëra në specifikimet teknike.

6. znj. Sh.H, për arsye se:

Në cilësinë e anëtares së komisionit të marrjes në dorëzim në procedurën e prokurimit me objekt: “Program kompjuterik për menaxhimin e magazinave dhe pajisja e tyre me barcode”, ka marrë në dorëzim sistemet e kërkuara, të cilat nuk i përmbushnin plotësisht kërkesat e bëra në specifikimet teknike.

7. z. K.S

8. z. A.Bnë cilësinë e anëtarëve të komisionit të përlllogaritjes së fondit limit, për arsye se:

Në preventivin e përgatitur për procedurën e prokurimit “Ndërtim tubacioni magjstral grupi Ca38-Ca17, në sektorin Cakran-Mollaj” është përlllogaritur pesha e tubit me parametra (Dn 168.3 mm, spesor 6.3 mm, gjatësi 2728 mm), në sasinë 77.2 ton, ndërkohë që nga ribërja e llogaritjeve pesha përkatëse rezulton 68.6 ton. Në këto kushte, është parashikuar më tepër vlera 1,292,408 lekë [(77.2-68.6) ton x 150,280 lekë].Fondi limit i përlllogaritur rezulton me vlerë 15,587,585 lekë. Duke qenë se oferta e shpallur fituese është më e vogël se fondi limit i rilllogaritur, vlera e mësipërme konsiderohet efekt negativ financiar.

E. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe pse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien dhe zbatimin e tyre.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte “Largim nga puna”, për:

z.K.B, me detyrë ish-administrator i Shoqërisë.

F. SHËNIM I KRYETARIT

1.Kjo praktikë shkon për dijeni ose indicienë Prokurori, mbas studimit të dosjes nga ana e Departamentit Juridik.

2. Kjo praktikë auditimi do të shqyrtohet edhe nga Drejtori i Përgjithshëm, pasi për arsye të ngarkesës në lidhje me përgatitjen e Raportit të Buxhetit Faktik 2018, nuk mund të kryhet brenda afateve të përcaktuara në Rregulloren e Procedurave të Auditimit.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R